Nr. 632 Prot
Dt. 14. 9. 2026

Nr 4343 Prot.
Datë 14.09.2026

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONERËVE TË SHOQËRISË "OSHISH" SH.A**

**VENDIM**

**Nr. 4 datë 14/09/2026**

**PËR**
**EMËRIMIN E ADMINISTRATORIT TË SHOQËRISË "OPERATORI I SHËRBIMEVE TË INTEGRUARA SHËNDETËSORE" SH.A (OSHISH SH.A)**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Vendimit nr. 845, datë 30.12.2025, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e shoqërisë aksionare "Operatori i Shërbimeve të Integruara Shëndetësore" sh.a. (OSHISH sh.a.), i ndryshuar, Statutit të shoqërisë "Operatori i Shërbimeve të Integruara Shëndetësore" sh.a., si dhe të vendimit nr. 1, datë 15.01.2026, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, për themelimin dhe miratimin e statutit të shoqërisë, aksionari i vetëm i shoqërisë OSHISH sh.a., i përfaqësuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale:

**VENDOSA:**

1. Emërimin e znj. Yllka Kukalaj, administratore e shoqërisë "Operatori i Shërbimeve të Integruara Shëndetësore" sh.a. (OSHISH sh.a.), për një mandat 3 (tre)-vjeçar nga data e miratimit të këtij vendimi.
2. Administratori ushtron të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në statutin e shoqërisë dhe në aktet e organeve drejtuese të saj.
3. Ngarkohen strukturat përgjegjëse të shoqërisë OSHISH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONERËVE**

**Përfaqësuesi i aksionarit shtet**

**Ministri i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale**

**KLODIANA SPAHIU**

Nr. 631 Prot
Dt. 14.9.2026

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
Nr. 4339/1 Prot.
Datë.më 11.09.2026

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONERËVE TË SHOQËRISË "OSHISH" SH.A.**

**VENDIM**

**Nr. 3, datë 11/09/2026**

**PËR**
**LIRIMIN E ADMINISTRATORIT TË SHOQËRISË "OPERATORI I SHËRBIMEVE TË INTEGRUARA SHËNDETËSORE" SH.A. (OSHISH SH.A.)**

Në mbështetje të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, të vendimit nr. 845, datë 30.12.2025, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e shoqërisë aksionare 'Operatori i Shërbimeve të Integruara Shëndetësore' sh.a. (OSHISH sh.a.)", i ndryshuar, të Statutit të shoqërisë "Operatori i Shërbimeve të Integruara Shëndetësore" sh.a., si dhe të vendimit nr. 1, datë 15.01.2026, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, për themelimin dhe miratimin e statutit të shoqërisë, aksionari i vetëm i shoqërisë OSHISH sh.a., i përfaqësuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale:

**VENDOSA:**

1. Lirimin e znj. Arisa Cane nga detyra e administratorit dhe e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë OSHISH sh.a., me efekt të menjëhershëm.
2. Znj. Arisa Cane të kryejë dorëzimin e detyrës, dokumentacionit, vulës, mjeteve dhe çdo aktivi tjetër të shoqërisë tek administratori i ri, kundrejt procesverbalit të dorëzimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONERËVE**

**Përfaqësuesi i aksionarit shtet**

**Ministri i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale**

**KLODIANA SPAHIU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE - TIRANË